



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.06.2022, merr këtë

V E N D I M
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale, në kategorinë e investimeve kapitale.

Neni 2

Sipas nenit I të këtij vendimi, nga fondi i rezervës komunale, mjetet në vlerë prej 4,060,000.00 €, orientohen në investime kapitale, respektivisht mjetet në vlerë prej 560,000.00 € orientohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit për projektin "Blerja e biçikletave publike", të cilat do të jenë në pronësi komunale, dhe mjetet në vlerë prej 3,500,000.00 € orientohen në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për projektin "Ndërtimi i rrugës "A", kolektori dhe rruga".

Neni 3

Sipas nenit II të këtij vendimi, shuma e mjeteve të transferuara është 4,060,000.00 €.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore me detajet e hollësishme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/01-151613/22, më 30.06.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupa

